

VENDIM
Nr. 1004, datë 9.12.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË TARIFËS SIPAS LLOJEVE TË PËRDORIMIT
TË FAUNËS SË EGËR DHE MËNYRAT E PAGIMIT TË SAJ¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”, të ndryshuar, me propozimin të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e masës së tarifës, sipas llojeve të përdorimit të faunës së egër, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 21, të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Personi fizik apo juridik, vendës apo i huaj, i licencuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, që kërkon të përdorë faunën e egër, paraqet pranë strukturës përgjegjëse për biodiversitetin, në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, kërkesën me shkrim në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar.

3. Pagesa e tarifës së përdorimit të faunës së egër kryhet në llogarinë bankare të ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe derdhet në llogarinë e unifikuar të thesarit. Të ardhurat e krijuara nga tarifat e përdorimit të faunës së egër derdhen 100% në buxhetin e shtetit dhe shpenzohen si pjesë e totalit të të ardhurave të këtij buxheti.

4. Tarifa e shërbimit, e paguar, është e pakthyeshme, pavarësisht nga fakti nëse kërkesa miratohet apo jo nga ministri përgjegjës për mjedisin.

5. Tarifat e përdorimit të faunës së egër për qëllime shkencore, në zonat e mbrojtura mjedisore, janë të përcaktuara në legjislacionin për zonat e mbrojtura.

6. Strukturat përgjegjëse për faunën monitorojnë nëse marrja në mjedisin natyror të ekzemplarëve të llojeve të faunës së egër dhe shfrytëzimi i tyre janë në përputhje me pagesën e kryer nga subjektet e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA 1

¹ Ky projektvendim është përafruar pjesërisht me: direktivën e BE-së nr. 92/43/EEC, datë 21 maj 1992, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e të faunës së egër”. Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 206, datë 22.7.1992, faqe 7–50.

TARIFAT E PËRDORIMIT TË FAUNËS SË EGËR

		Tarifa për person fizik	Tarifa për person juridik
1.	Përdoruesit e llojeve të faunës së egër apo i individëve të tyre	-	15,000 lekë
2.	Kërkime shkencore Tarifat për qëllime të kërkimit shkencor dhe të grumbullimit të materialit gjenetik dhe të mostrave. a) Hulumtuesit, studiuesit dhe specialistët e autorizuar për të kryer kërkime dhe monitorime të karakterit shkencor-studimor, b) Grumbullimi i materialeve gjenetike dhe i mostrave: Për llojet e florës së egër c) Për llojet e faunës së egër	5,000 lekë 1.000 lekë/muaj/personi 3.000 lekë/mostra 10.000 lekë/mostra	Veprimtaritë e përcaktuara në këtë pikë nuk janë të aplikueshme për persona juridikë.
3.	Veprimtari kulturore	3,000 lekë	5,000 lekë
4.	Veprimtari edukative	100 lekë	1,000 lekë
5.	Koleksione zoologjike	20,000 lekë për koleksion	30,000 lekë për koleksion
6.	Përfitimim e produkteve jetësore ose për përdorimin e veprimtarive të tyre jetësore (për qëllime shkencore)	10,000 lekë	15,000 lekë